



UDHËZUES PËR PËRDORIMIN E APLIKACIONIT MOBILEBANKING



BPB

Banka e vendit tënd



Parakushtet

Parakushtet për shfrytëzimin e aplikacionit

Aktivizimi dhe logimi

Si ta aktivizoj aplikacionin mBanking?

Shikimi i gjendjes

Si ta kontrolloj gjendjen në llogari ?

Si ta kontrolloj gjendjen në kartelë?

Qarkullimi

Si ta shoh qarkullimin për llogari?

Si ta shoh qarkullim në kartelë?

Pagesat

Si të kryejë një pagesë të re?

Puna me shabllone

Si ta ruaj shabllonin?

Këmbimorja

Si ta shoh kursin valutor?

Informatat

Si të marr kontakt informata për bankën?

Puna me aplikacion

Si ta ndrojt PIN-in?

Si ta ndryshoj gjuhën në aplikacion?

Parakushtet per shfrytëzim të aplikacionit mBanking


Për instalim dhe fillim të suksesshëm të aplikacionit duhet të plotësohen kushtet në vijim :

- telefoni mobil që përkrahë Java2 Mobile Edition (J2ME) versionet MIDP 2.0 i CLDC 1.1 ose me të re
- memorie të mjaftueshme për instalim të aplikacionit (cca 200KB – 350KB, varësisht prej aplikacionit)
- disa pajisje nuk mund të instalojnë aplikacione më të mëdha se 128KB përdoruesi duhet të ketë të mundur qasje GPRS nga pajisjet mobile


Si ta aktivizoj aplikacionin mBanking?

Pas shkarkimit të aplikacionit në pajisjen tuaj, mBanking duhet të startoj me ç`rast do të paraqitet forma si në fig (varësisht prej modelit të telefonit, aplikacioni mund të startohet pas instalimit automatikisht).

Duhet të shënohet kodi aktivizues (i cili merret prej bankës) dhe pastaj të shtypet butoni Vazhdo. Menjëhere pas kësaj hapet forma ku duhet të futet PIN-i me të cilin do të logoheni në të ardhmen për punë me mBanking.



Pas shtypjes së butonit Vazhdo , pastaj Vazhdo aplikacioni lidhet përmes GPRS me shërbimet e mbanking-ut dhe vërtohet kodi i aktivizimit që e keni shënuar. Nëse çdo gjë ka kaluar pa gabime , shfrytëzuesi është autentifikuar me sukses dhe atëherë paraqitet forma si në vijimë:



Me këtë rast mBanking aplikacioni është aktivizuar për shfrytëzuesin dhe është gati për punë.


*Pin është 4 shifror dhe duhet domosdoshmerisht të mbahet mend, në të kundërtën duhet të kërkontë prej bankës aplikim të ri.

* Pajisja e juaj duhet të ketë GPRS shërbimin; nëse nuk jeni të sigurtë kontaktoni operatorin tuaj mobil.


Si ta kontrolloj gjendjen në llogari ?

Pas logimit në aplikacion, do të paraqitet forma si në figurën më poshtë:

Nese shtypim tek Llogarite atehere paraqitet forma si ne figuren me poshte:



Pasi të zgjedhim menyn llogarite dhe pastaj menyn gjendjet, paraqiten gjendjet në të gjitha llogaritë rrjedhëse, të kursimit dhe afatizmit si në fig:




Për të parë gjendjen e llogarisë zgjedhni llogarinë që dëshironi dhe do të paraqitet forma si në fig.




Kthimi në menyne kryesore mundesohet përmes butonit Prapa.

Si ta kontrollojë gjendjen në kartelë?


Pas logimit në aplikacion, shfaqet forma si në fig.



Pasi të shtypim Kartelat paraqitet mundësia për të parë kartelat e klientit si në fig:



Për të parë detajet për kartelë zgjedhni kartelën dhe do të paraqitet forma si në fig më poshtë me llogarinë e kartelës:






Kurse kthimi në menyën paraprake bëhet me shtypjen e butonit Prapa.

Si ta kontrollojë gjendjen në kartelë?

Pas logimit në aplikacion, shfaqet forma e ngjashme si në fig.

Duke zgjedhur menyën Llogarite pastaj Transaksionet shfaqet forma si në fig.





Pas zgjedhjes së llogarisë dhe shtypjes së butonit Vazhdo, shfaqet forma si në fig:

Qarkullimi i llogarisë mund të kërkohet:

- **Për numër të ditëve** – specifikoni numrin e ditëve duke u llogaritur nga dita e fundit e prapa dhe shtypni butonin Përfundo. Qarkullimi mund të kërkohet deri në periudhën prej 30 ditëve të fundit apo sipas zgjedhjes. (Ky option nuk duhet të jetë më shumë se 30 ditë).

- **Numri i transaksioneve** = mundësia e zgjedhjes është për 30 transaksionet e fundit ose një numër tjetër (ky option nuk duhet të jetë më shumë se 30 transaksione)




Në vazhdim paraqiten informatat për transaksionet e kërkuara me datën e realizimit të transaksionit dhe bilancin e mbetur.



Data	Shuma	Bilanci
10.12.2015	0.00 EUR	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR	0.00 EUR

Për paraqitje me detaje, zgjidhni transaksionin e dëshiruar dhe shtypni butonin Detajet. Kthimi në menynë kryesore bëhet duke shtypur butonin Menyja kryesore.



ID e Transaksionit
994

Llogaria e dërguesit
1300

Pronari
VIO

Llogaria e përfituesit
N/A


Emri i përfituesit
PRISHTINE

Adresa e përfituesit
PRISHTINE

Detajet e pagesës
SMS Banking - Regjistrim Kontrate

Shuma
0.00 EUR


- Për periudhën-
mundësia e zgjedhjes është për 1 vit prapa, por duke nxjerr shënime vetëm për 30 transaksione nga periudha e zgjedhur.



Numri i ditëve
Për periudhën


Numri i transaksioneve
Prej 03.08.2007 Deri 03.08.2017

Vendosni periudhën për të cilën dëshironi të merrni informata për transaksionet e realizuara. Në vijim do të paraqiten informatat për periudhën e zgjedhur.



MB-BPB	
10.12.2015	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR
10.12.2015	0.00 EUR


Për më shumë detaje për transaksionin e zgjedhur, klikoni në butonin Detajet. Kthimi në menunë kryesore bëhet duke shtypur butoni Menyja kryesore.




MB-BPB	
ID e Transaksionit	99400004207001
Llogaria e dërguesit	1300
Pronari	VIOL
Llogaria e përfituesit	N/A
Emri i përfituesit	
Adresa e përfituesit	PRISHTINE
Detajet e pagesës	SMS Banking - Regjistrim Kontrate
Shuma	0.00 EUR

Si ta shoh qarkullim ne kartelë?

Pas logimit në aplikacion , shfaqet forma si në fig:



Me shtypjen në Kartelat, pastaj Transaksionet dhe zgjedhjes së kartelës së dëshiruar shfaqet forma e ngjashme si në fig:





Qarkullimi i llogarisë mund të kërkohet:

- **Për numër të ditëve** = specifikoni numrin e ditëve duke u llogaritur nga dita e fundit e prapa dhe shtypni butonin Përfundo. Qarkullimi mund të kërkohet deri në periudhën prej 30 ditëve të fundit apo sipas zgjedhjes. (Ky opsion nuk duhet të jetë më shumë se 30 ditë).


- **Numri i transaksioneve** = mundësia e zgjedhjes është për 30 transaksionet e fundit ose një numër tjetër (ky opsion nuk duhet të jetë më shumë se 30 transaksione)

- **Për periudhën** = mundësia e zgjedhjes është për 1 vit prapa, por duke nxjerr shënime vetëm për 30 transaksione nga periudha e zgjedhur.




Pas zgjedhjes së kartelës së dëshiruar dhe shtypjes së butoni detajet, paraqitet forma si me poshtë:

Nëse doni të dini detajet për transaksionin e caktuar shtypni butonin Detajet



Si të kryejë një pagesë të re?


Pas logimit në aplikacion, shfaqet forma si në fig:



Duke shtypur Pagesat, paraqitet opcioni për të zgjedhur formën për pagesë të re apo për të përdor Shabllonin.



Pas zgjedhjes së butonit Pagesë e re do të paraqitet forma ku janë të listuara llogaritë rrjedhëse prej të cilave mund të bëni pagesa.




Pas zgjidhjes së llogarise së dëshiruar dhe shtypjes së butonit Vazhdo, paraqitet forma si në fig:



Ju duhet të plotësoni fushat e paraqitura në formë ashtu që zgjedhni Bankën pranuese, shënoni llogarinë e përfutuesit, emrin e përfutuesit, jepni

një përshkrim të pagesës që dëshironi ta realizoni, shumën e pagesës dhe përcaktoni nëse duhet që pagesa të procesohet me prioritet nga banka (pagesa mund të bëhet vetëm në valute të njejtë).




Me pas e ekzekutoni pagesën duke shtypur butonin Ekzekuto Urdhëresën dhe do të pranoni mesazhin konfirmues në rastin kur pagesa kryhet me sukses dhe do t'iu kërkojë të ruani formën si Shabllon.


Si ta ruaj shabllonin?

Ju mund ta ruani formën e plotësuar me këto detaje të pagesës dhe ta thirrni çdo herë kur beni pagesë të ngjashme që të mos keni nevojë rishtas të plotësoni shënimet e njehta.

Forma në këtë rast do të ruhet tek Shabllonet



Nëse klioni tek forma Shabllonet do t'iu paraqiten shabllonet që i keni ruajtur më parë.




Ju mund të zgjedhni shabllonin e caktuar, të editoni shënimet dhe pastaj ta azhuronit ate.



Si të marr kontakt informata për bankën?

Pas logimit në aplikacion hapet forma si më poshtë:




Pas klikimit ne opsionin Informata dhe pastaj Kontaktet do të paraqiten format të cilat varësisht prej zgjedhjes përmbajnë informata kontaktuese për bankën, psh Qendra e thirrjeve.




Zgjedhim psh. Qendra e thirrjeve dhe do të paraqitet forma, e cila përmban numrin e telefonit për sektorin gjegjës në bankë. Me opsionin Thirr, ju mund të telefononi në numrin e paraqitur në ekran dhe të komunikoni direkt me përgjegjësit nga banka.

Si të shoh kursin valutor?

Pas logimit në aplikacion hapet forma si më poshtë:



Pas klikimit ne opsionin Këmbimore dhe pastaj Kursi i Këmbimit do të paraqiten valutat për të cilat mund të merrni kursin e bankës.





Selektoni valutën për të cilën dëshironi të merrni kursin valutor dhe shtypni butonin Zgjedh. Do të paraqitet forma si në vijim.

Nëse nuk ka shënime nga banka për kursin valutor të datës së zgjedhur do të paraqitet porosia si në fig.



Si ta ndryshoj PIN-in?

Pas logimit ne aplikacion , paraqitet forma si në fig




Shtypni butonin Ndrysho PIN-in , dhe futni PIN-in e vjetër dhe të riun (konfirmojeni të riun) dhe në fund shtypni butonin Përfundo.




Si ta ndryshoj gjuhën në aplikacion?

Ku funksion mund të kryhet përmes fomës e cila paraqitet pas logimit në aplikacion duke shtypur në Parametrat.



Pas zgjedhjes së dëshiruar bëhet edhe ndryrimi i gjuhës së aplikacionit ku paraprakisht paraqitet porosia si në fig.



**UDHËZUES
PËR PËRDORIMIN E
APLIKACIONIT
MOBILEBANKING**



www.bpbbank.com